



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBESHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SUPERVIZION "NDËRTIM PUSE DUBLIKANT, RRETHIM DHE PASTRIM TE PUSEVE
EKZISTUESE NË ZONËN E SHËRBIMIT TE SHOQERISE RAJONALE UK DURRES"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV: 71247000-1 - MBIKËQYRJA E PUNËS SË NDËRTIMIT

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,014,777.16 (një milion e katërbëdhjet mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë presje gjashtëmbëdhjet) lekë pa tvsh.

Referuar shkreses Nr 1834/1 Prot dt 21.03.2023, dhe në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Argumentim:

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **Supervizion "Ndërtim puse dublikant, rrethim dhe pastrim te puseve ekzistuese në zonën e shërbimit te shoqerise Rajonale UK Durres"**

Mbështetur në Seksioni III "VEPRA INXHINIERIKE"

"Tabela shoqëruese e tarifave -", GRUPI TARIFOR II

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit 2.2

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021 dhe 2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 . Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021 dhe 2022** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim të punimeve objekt i kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licencë profesionale të shoqërisë për supervizion punimesh të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente të tyre:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

N.P-1-Punime gërmimi në tokë.

N.P.2 – A- Ndërtime civile dhe industriale

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S1 – A- Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S4 – A- Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri,plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

N.S.20 – A - Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr 759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentim:

- N.P. 1 (Punime gërmimi në tokë) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime gërmimi.
- N.P.2 – A- (Ndërtime civile dhe industriale) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi nderhyrje ne objektet e depove dhe rrethimet e tyre.
- N.S-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime prishje te objekteve ekzistuese qe perfshihen ne zonene e projektit .
- N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri,plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime rifiniture te muratures qe perfshihen ne zonene e projektit.
- N.S-18 (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime puse shpime per uje.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’’, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 ‘‘Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi’’, i ndryshuar. Licensat e mësipërme kërkohen në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, ‘‘Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi’’. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (drejtues teknik) , të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj,

Ka si drejtues teknik të punësuar dhe të përfshirë në liçencën e shoqërisë minimalisht:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi / Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier Gjeodet/ Marshejder/Topograf
- 1(një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) CV-në e tyre,
- b) Diplomat,
- c) Kontratë individuale pune të noterizuar
- d) Liçencën personale të mbikqyrjes të tyre.

Drejtuesit teknike të kërkuar më poshtë duhet të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së tenderit (formularet E-ig025/a.1):

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 3 (tre) persona** për periudhën **3 (tre) muajt e fundit** e vertetuar kjo me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
2. Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Në numrin total të punonjësve të kërkuar janë përfshirë edhe stafi inxhinierik i kërkuar në license, ai i kërkuar mbështetës si dhe stafi me kualifikimet perkatëse. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Në bazë të volumit dhe natyrës së punimeve të cilat janë punime germimi dhe shtrimi tubacioni pasi kanë të bëjnë me ndërtim nga fillimi dhe kërkojnë vëmendje dhe kontroll rigoroz.

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

A. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira instrumentat topografike si më poshtë:

1. Pajisje Total Station 1 (nje) copë;

Në lidhje me sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë Qiraje të noterizuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

B. Kandidati/ ofertuesi për realizimin e kontratës duhet të disponojë të paktën 1 (nje) mjet transporti të specialistëve. Për të veretuar këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Për të dëshmuar këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

1. Për mjetet ne pronesi qe shenohen ne Regjistrat publike, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne rregjistrimin e mjetit si: Leje Qarkullimi, Siguracionin e mjetit dhe Çertifikatën e Kontrollit teknik.
2. Për mjete e marra me qera dokumentave te mesiperme ti bashkëlidhen Kontrata perkatese te qerese / leasing / huaperdorjes, në emër të objektit, të jenë të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të perfshijë periudhën e ndërtimit të objektit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesiperme jane vendosur ne perputhje me natyren e punimeve dhe volumin e punimeve te percaktuar ne preventivin e punimeve.

Numri i paisjeve dhe i makinave te transportit jane vleresuar si te nevojshme ne perpjesetim me natyren e kontrates, duke iu referuar grafikut te punimeve, kohezgjatjes se punimeve dhe specifikimeve teknike te punimeve.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- a) Çertifikate ISO 9001-2015 ”Per sistem menaxherial te cilesise”, te vlefshme *ose ekuivalente*.
- b) Çertifikate ISO 14001-2015 ”Per sistem menaxherial te mjedisit”, te vlefshme *ose ekuivalente*.
- c) Çertifikate ISO 18001-2007 ose 45001-2018 ”Per sistem menaxherial te shendetit dhe sigurise ne pune”, te vlefshme *ose ekuivalente*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto

certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Ne rast se oferta është me e ulët se minimumi i përcaktuar në këtë vendim ajo do të skualifikohet. Ky kriter bazohet në rekomandimin e APP-se me shkresat Nr.5585 Prot. me datë 25.07.2017. Ofertuesit duhet të plotësojnë në mënyrë rigoroze ofertën sipas shtojcës 1. Ofertuesit në përgatitjen e ofertes duhet të kenë parasysh që të mos tejkalojnë vlerën e fondit limit për çdo projekt. Mosplotësimi i saktë i kësaj oferte përben kusht për skualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në dokumentat teknike dhe terma të referencës së tenderit janë shprehur qartë kërkesat AK për cilësinë e të gjithë punimeve dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e kontratës.

***Shënim:** Për më shumë informacion rreth dokumentacionit, referohuni procedurës me numër referencë: **REF-68411-05-05-2023**.*